

NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të Energjisë Elektrike në Kosovë

RENRGY TRADING GROUP PRISTINA SHPK., me seli në adresën: Rruga Sylejman Vokshi, nr. 50/3, Prishtinë, Republika e Kosovës, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të **Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë**. Aplikacioni për licencim të këtij aktiviteti me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Licencimi i furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike i ndërmarrjes **RENRGY TRADING GROUP PRISTINA SHPK.** përveç tjerash do të përmbajë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blejë kapacitete dhe energji elektrike nga prodhuesit me çmime të parregulluara;
- I licencuari ka të drejtë të blejë dhe shesë kapacitete dhe energji elektrike nga furnizuesit e tjerë me çmime të parregulluara;
- I licencuari ka të drejtë të shesë kapacitete dhe energji elektrike furnizuesve tjerë me çmime të parregulluara; dhe
- I licencuari ka të drejtë të tranzitojë, importojë dhe eksportojë kapacitete dhe energji elektrike.

I licencuari mund të kryejë aktivitetin e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në pajtim me dispozitat e Licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. "Dervish Rozhaja", Nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrexhaj@ero-ks.org; Tel.038247615/118.

RENRGY TRADING GROUP PRISTINA SHPK.

Rruga "Sylejman Vokshi", nr. 50/3, Prishtinë, Kosovë